



Folkpartiet på andra språk: albanska

Partia popullore – partia liberale e Suedisë

Partia popullore liberalët është partia liberale e Suedisë. Që nga viti 2006 jemi të përfshirë në qeveri, së bashku me partitë tjera në Aleancën për Suedinë. Ne tani kërkojmë besimin sërish – për hir të punës dhe shkollës.

Çështjet tona kryesore janë:

- » **Shkolla.** Rezultati i diturisë në shkollën suedeze duhet të përmirësohet. Ne dëshirojmë të aplikojmë më herët notën dhe ne po ashtu kemi aplikuar një kontroll të hershëm të diturisë, ashtu që nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë, t'u ofrohet atyre sa më shpejt që është e mundur. Mësuesi duhet të ketë kompetenca më mëdha të krijoj rregull dhe qetësi për punë. Ngacmimet duhet të luftohen fuqishëm.
- » **Punë dhe biznes.** Duhet të jetë me leverdi të punosh dhe të shkollohesh. Ne i kemi ulur taksat për ata me rroga të ulëta dhe të mesme, me më se 1 000 korona në muaj. Ne dëshirojmë të vazhdojmë me uljen e taksave të rrogave dhe të përmirësojmë kushtet e ndërmarrjeve. Ne, po ashtu, dëshirojmë të aplikojmë punë shëgertësh, ashtu që më shumë të rinj të futen në tregun e punës.
- » **Siguria.** Të gjithë ata të cilët punojnë duhej të kishin një mbrojtje nga sigurimi ndaj papunësisë. Sot nuk është kështu. Ne, po ashtu, dëshirojmë të përmirësojmë sigurinë për të moshuarit dhe të nxjerrim ligjin që një çift i moshuar të ketë të drejtë të banojë së bashku, edhe në rastin kur njëri nga ata detyrohet të banojë në shtëpinë e pleqve. Lufta ndaj krimit të rëndë e të organizuar, duhet të intensifikohet.
- » **Integrimi.** Kur Socialdemokratët e dorëzuan pushtetin, integrimi funksiononte aq keq sa që një i sapoardhur gjente punë mbas shtatë vjetëve. Ne e dimë se puna dhe njohuritë e gjuhës suedishte janë çelësi i integritimit – prandaj ne i ulim shpenzimet për ndërmarrjet të cilat punësojnë të sapoardhurit. Mësimi i gjuhës suedishte për imigrantë ka kërkesa të qarta dhe ka mësues më të arsimuar. Ne dëshirojmë të rregullojmë zonat e shkatërruara të banimit dhe t'i rrënojmë ato pjesë të ndërtimeve ku ka nevojë
- » **Evropa dhe bota.** Ne nuk dëshirojmë të vendosim mure ndaj botës – ne duam t'i hapim dyert. Tregtia e lirë është gjë e mirë si për Suedinë ashtu edhe për vendet tjera. Suedia duhet plotësisht të jetë anëtare e BE-s – prandaj ne i themi po euros. Refugjatët duhet të kenë të drejtë të qëndrojnë këtu për t'i ikur përnd-

Välkommen att
kontakta oss
om du vill veta mer
eller bli medlem!
www.folkpartiet.se
info@liberal.se
020-53 53 53

Vill du hjälpa till i valkampanjen?
SMS:a VOLONTÄR till 72080
så kontaktar vi dig.
Kostar som ett vanligt SMS.

jekjeve në vendin e tyre. Ne e mbrojmë synimin që një për qind i prodhimit bruto kombëtar të Suedisë të destinohet për ndihmë. Të hollat duhet të përdoren për të luftuar varfërinë dhe të forcojë zhvillimin demokratik. Regjimet diktatoriale nuk duhet të përfitojnë nga ndihmat e Suedisë.

- » **Barazia.** Zvogëlo ndërlikimet për të fituar bonus barazie për leje për prindërit – të hollat duhet drejtpërdrejtë të shkojnë në llogarinë e pagës, pa pasur nevojë të bësh kërkesë. Ne vënë në jetë një bonus barazie, që jep më shumë të holla çiftëve të cilët i ndajnë baras ditët e punës atëherë kur fëmija është i sëmurë. Ashpërso shkallën e dënimit për fyerje të rëndë të qetësisë së gruas. Vë pranga elektronike të këmbës burrave të cilët thyejnë vendimin e ndalesës së vizitës.
- » **Klima.** Ndryshimet e klimës janë sot rreziqet më të mëdha për mjedisin. Ne dëshirojmë të ruajmë dhe të zhvillojmë energjinë bërthamore suedeze, për të zvogëluar ndotjen nga karbon dyoksidi. Nevojitet një marrëveshje zotuese ndërkombëtare mbi klimën. Energjia e erës dhe energjia tjetër ripërtëritëse, ka nevojë të ndërtohet dhe të rritet kursimi i energjisë.

Sfidat e të ardhmes

Kriza ndërkombëtare ekonomike e ka përfshirë rëndë Suedinë. Por, duke ju falënderuar masave politike më përgjegjësi të Qeverisë së Aleancës, Suedia ia doli krizës më mirë se shumë vende të tjera.

Ne, në rend të parë e kemi vënë punën. Duke ju falënderuar një politike financiare me përgjegjësi, ne kemi mundur të stimulojmë ekonominë. Pa financa shtetërore të mirëmbajtura, rënia e viteve të fundit do të rezultonte në rënie të mirëqenies si dhe në ngritje të taksave.

Për periudhën tjetër mandatarin, shanset janë të mira për një rritje ekonomike. Por, fuqia e rimëkëmbjeve së brendshme varet nga politika që do të kemi këtu në vend. Vendimtare është që më shumë veta të punësohen. Zbritja e taksave të punës ka marrë me vete që të jetë më e leverdishme të punosh, por ka nevojë edhe për ndryshime të tjera të taksave dhe rregullave.

Të rinjve të cilët kanë nevojë të mësojnë një profesion duhet t'u ofrohet një punë shëgjertë.

Duhet të jetë e leverdishme të arsimohesh. Duhet të jetë e leverdishme të rrezikosh dhe të startosh ndërmarrjen tënde. Duhet të jetë më e thjeshtë të punësosh njerëz. Suedia duhet të jetë një vend në majë të shigjetës që mund të tërheq studiues shkencorë dhe ide të reja nga vendet tjera.

Vendi ynë është i varur nga industria intensive nga aspekti i energjetikës. Energjia e re bërthamore e cila i zëvendëson reaktorët e dalë nga përdorimi, për shkak se janë vjetruar, bën që Suedia mund të ketë energji elektrike të liruar nga karbon dyoksidi për industrinë tonë kryesore.

Për të qenë me dobi të punosh dhe të arsimohesh, Suedia duhet t'i rikthehet "gjysmës së mbetur" të një shtimi të pagës – askush nuk duhet të paguaj më shumë taksë se 50 për qind, për një qindëshin e fundit të fituar.

Çelësat për një integrim të suksesshëm janë puna dhe njohuria e suedishtes. Mësimi i suedishtes për imigrantë ka nevojë të përmirësohet. Puna e hapit hyrës (sued. instegsjobb) dhe puna e fillimit të ri (sued. nystartsjobb), e bën më të lehtë për të sapoardhurit, të hyjnë në tregun e punës.

Për atë që e humbë punën, është vendimtare që të ketë një sigurim ndaj papunësisë, i cili funksionon. Një sigurim i përgjithshëm ndaj papunësisë, duhet të aplikohet.

Një shkollim të klasës botëror

Shkolla është vegla jonë më e mirë për t' u dhënë të gjithë njerëzve shansin e njëjtë në jetë. Me një politikë të drejtë për shkollën, të gjithë nxënësit mund të kenë shansin të arrijnë sukses.

Ky fillim i ri, i cili aplikohet në shkollën suedeze, është një detyrë kryesore për Partinë popullore. Nota do të aplikohet që nga klasa e gjashtë dhe një arsimim i ri për mësuesit është arritur për t' u vënë në jetë. Provimet kombëtare në klasën e tretë të cilat tani aplikohen, do të ndjeket në vazhdim. Shteti duhet të merr përsipër përgjegjësinë kryesore për shkollën.

Një mënyrë për t' u përballur me globalizimin është njohja e mirë e gjuhëve të huaja. Prandaj duhet nxënësi i cili i mëson së paku dy gjuhë të huaja në shkollën fillore, t' i llogaritet kjo kur ai ose ajo aplikon për në gjimnaz. Kinezishtja duhet të bëhet një gjuhë e re e huaj në gjimnaz.

Bashkëpunim në kohën e globalizimit

Suedia do t' i hap dyert ndaj botës – jo të jetë e mbyllur me mure. Para së gjithash përmes BE-s, Suedia ka mundësi të merr pjesë dhe të ndikojë në zhvillimin botëror. Ne dëshirojmë të thellojmë bashkëpunimin evropian, euroja duhet të futet në përdorim si valutë në Suedi.

Të gjithë përfitojnë nga tregtia e lirë. Muret doganore të BE-s ndaj vendeve të varfra, duhet të rrënohen. Bota e pasur, ka po ashtu një përgjegjësi morale, të mbështes luftën kundër varfërisë dhe për demokraci. Synimi i një përqindëshit si ndihmë duhet të arrihet.

Ne mbrojmë një politikë bujare për refugjatët. E drejta e azilit është një e drejtë njerëzore. Njerëzit në ikje nga përndjekja, kanë të drejtë mbrojtje në Suedi dhe në vendet tjera të lira.

Siguri

Siguria ndaj krimit duhet të shtohet. Ne kemi shtuar numrin e policëve nga 17 000 në 20 000. Puna parandaluese dhe reagimet e shpejta, janë sidomos të nevojshme, për të ndaluar të rinjtë që të mos mbërthehen në kriminalitet.

Nuk është e denjë që një vend në mirëqenie t' i detyrojë njerëzit të cilët kanë jetuar jetën bashkë, t' i ndajë ata, kur njëri prej tyre nuk ia del më të banojë në shtëpi. Ka nevojë për një ligj të ri për të mbrojtur të drejtën e çiftëve të moshuar, që ata të banojnë së bashku – edhe kohën e fundit të jetës së tyre.

Investime në vazhdim duhet të bëhen në psikiatrinë. Ai/ajo që kërkon ndihmë psikiatrike urgjentisht, duhet t' i jepet ndihma menjëherë. Mungesa e disponueshmërisë për persona me të meta në zhvillim, duhet të shihet si diskriminim.

Veprim i fuqishëm për barazi

Barazia është një çështje lirie. Ne duhet të vazhdojmë të përqendrohemi në parësinë ekonomike të grave. Puna jo vullnetare me orar të pjesshëm, duhet të luftohet. Për të inkurajuar barazinë në mes prindërve, bonusi i barazisë duhet të thjeshtësohet dhe të zhvillohet.

Dhuna nga e cila pësojnë gratë, pikërisht pse ato janë gra, është një çështje urgjente e barazisë. Lufta ndaj krimeve seksuale duhet të forcohet dhe më shumë të përqendrohemi tek autorët.

Energjia bërthamore për hir të klimës

Çështja e klimës si çështje e vetme është sfida më e madhe globale me të cilën ne ballafaqohemi. Suedia dhe BE, duhet të vazhdojnë përpjekjet, për një marrëveshje globale për klimën dhe ne duhet të ecim përpara me synime të mëdha për klimën.

Energjia e re bërthamore do të ndërtohet e të zëvendësojë reaktorët e sotëm të cilët kanë dal jashtë përdorimit. Një kombinim i energjisë së re bërthamore dhe investimet në energjinë e ripërtëritur, bën që prodhimi i energjisë së Suedisë edhe në të ardhmen të jetë i liruar nga karbon dyoksidi. Në punën për klimën është qendrore të ruhet shumëllojshmëria biologjike dhe mos të humbim synimet tjera mbi mjedisin si punën për mjedisin detar.

Një zhvillim të makinës elektrike do të zvogëlonte shumë derdhjet në natyrë nga mjetet e transportit. Një shpërblim i klimës do të aplikohet.